



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2614 Prot.

Roskovec, më 02.06 2020

VENDIM

NR. 37. DATË 29.05. 2020

**“PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR FUNKSIONIMIN E TREGUT PUBLIK NË
BASHKINË ROSKOVEC”.**

Në mbështetje të ligjit Nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”,
neni 54 gërma “k”, të ligjit Nr.68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”
neni 7 pika 1 dhe neni 15 pika 3, *Këshilli i Bashkisë*,

VENDOSI:

- 1- Miratimin e Rregullores për Funkcionimin e Tregut Publik në Bashkinë Roskovec me qëllim përcaktimin e kushteve dhe procedurave të detajuara për rregullat dhe kushtet e zënies/përdorimit të tregut publik në Bashkinë Roskovec.
- 2- Ngarkohet Drejtoria e të Ardhurave Vendore dhe Policia Bashkiake me zbatimin e këtij vendimi.
- 3- Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Rregullorja për Funkcionimin e Tregut Publik në Bashkinë Roskovec.
- 4- Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Kadri Hyska



RREGULLORJA
PËR FUNKSIONIMIN E TREGUT PUBLIK
NË BASHKINË ROSKOVEC



Baza Ligjore

Në mbështetje të nenit 8, pika 1, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja "a", nenit 23, pika 14, nenit 33, pika 1, shkronja "ç", nenit 54, shkronja "k", nenit 55, pikat 2 dhe 6 dhe nenit 64, shkronja "c"

të ligjit 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; nenit 113

të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; nenit 4/1

të ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin territorit" (i ndryshuar); nenit 15, pika 3

të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore"; nenit 8

të ligjit nr. 8224, datë 15.05.1997 "Për organizimin dhe funksionimin e Policisë së Bashkisë dhe Komunës" (i ndryshuar); nenit 10, nenit 11, nenit 15 dhe nenit 17

të vendimit nr. 1096, datë 28.12.2015 të Këshillit të Ministrave "Për Miratimin e rregullave, kushteve e procedurave për përdorimin dhe menaxhimin e hapësirës publike",



PJESA E PARË

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Objekti dhe qëllimi

1. Kjo rregullore ka si objekt përcaktimin e kushteve dhe procedurave të detajuara për rregullat dhe kushtet e zënies/përdorimit të tregut publik në Bashkinë e Roskovecit.
2. Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i të drejtave dhe detyrimeve për një përdorim sa më uniform të hapësirës publike me qëllim krijimin e një mjedisi urban të rregullt dhe funksional në shërbim të komunitetit dhe sigurisë publike, nëpërmjet krijimit të një marrëdhënie transparente ndërmjet komunitetit dhe organeve autorizuese dhe inspektuese të Bashkisë Roskovec, me qëllim disponimin racional të burimeve të përbashkëta.

Neni 2 Përkufizime

Për qëllime të aplikimit të kësaj rregullore, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. **“Hapësirë publike”** është hapësira e jashtme, si trotuari, rruga, sheshi, lulishtja, parku e të tjera të ngjashme, në shërbim të komunitetit, ku menaxhimi mund të jetë publik dhe/ose privat. Hapësira publike përfshin rrugëkalime publike dhe mjedise që janë të hapura për publikun ose në shërbim të përdorimit publik, pavarësisht nga regjimi juridik i tokës dhe përtej përcaktimeve të pronës publike, sipas ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit” (i ndryshuar).
2. **“Shërbimet e lejuara”**, shërbimet që autoriteti vendor lejon të kryhen në hapësirë publike, sipas kategorive të lejuara të përdorimit të tokës, dhe që janë të përputhshme me ndërtimet rreth hapësirës ku ato krijohen, sipas ligjit dhe dokumenteve të planifikimit.
3. **“Trotuar”**, është zona ndërmjet objekteve dhe karrexhatës që përdoret për aksesin e këmbësorëve. Matet nga fasada e objektit deri në fundin e bordurës së trotuarit.
4. **“Bordura”**, është element i parë që ndan karrexhatën me trotuarin.
5. **“Element Urban”**, është zona në të cilën bëjnë pjesë elemente si pemë në krah të trotuarit, gjelbërim apo shkurre, koshat e plehrave, reklammat, ndriçuesit rrugor, stolat etj.
6. **“Zonë Lëvizëse”**, është hapësira publike që lejon kalimin e këmbësorëve në mënyrë lineare, paralel me karrexhatën dhe pa ndërprerje e cila duhet të jetë e lirë gjithmonë.
7. **“Njësi tregtimi”** është ambienti i mbyllur (dyqan) në të cilin subjekti kryhen aktivitetin e tij. Njësitë e tregtimit mund të jenë të shkëputura nga ndërtesa ose mund të përfshihet në të.
8. **“Treg i lëvizshëm”**, kuptohet ajo formë organizimi e tregtisë ambulante në hapësirat publike që kryhet nëpërmjet grupimit të tregtarëve ambulantë në vende të caktuara, një ditë dhe një orë të caktuar, të cilët zhvillojnë aktivitetin e tyre me anë të pajisjeve të çmontueshme (banakë, tezga).
9. **“Aktivitet njësi shitjeje ambulatorë në hapësirat publike”**, kuptohet çdo njësi shitjeje ambulantë e lëvizshme jashtë tregjeve.



Neni 3
Oraret e tregtimit

1. Hyrja e mjeteve dhe sistemimi i mallit nga ora 4.00 deri 06.00
2. Orari i zhvillimi i tregut nga ora 06.00. deri 13.00
3. Largimi i mallrave dhe automjeteve nga ora 13.00 deri 14.30

Neni 4
Mallrat që do të tregtohen dhe vendi i tregtimit

1. Mallrat që do të tregtohen ndahen ne kategori sipas llojit:
 - a) Artikuj industrial, veshmbathje... etj.
 - b) Fruta, Perime, produkte te tjera bujqesore dhe ushqimore...etj..
 - c) Peshk, mish... etj.
 - d) Shpend...etj.
2. Vendi i tregtimit përcaktohet sipas hartës treguese bashkëlidhur

Neni 5

Detyrimet financiare

1. Vendi në të cilën ambulanti ushtron aktivitet tregëtarë në tregun publik dhe pagesa e tarifës përcaktohet në vendimin përkatës të Këshillit Bashkiak bazuar në ligjin "Për sistemin e Taksave(i ndryshuar)
2. Pagesa mblidhet nga inspektoret e tregut të cilët dalin në terren. Inspektoret dhe policet bashkiak duhet te jene te pajisur me dokument identifikimi dhe/ose uniforme.

Neni 6

Levizja e automjeteve te tjera

Levizja e makinave te tjera me tonazhe te ndryshme do te rregullohet ne baze te sinjalistikes rrugore dhe sipas emergjences në rrethana të caktuara.

Neni 7

Distancat

1. Në këtë nenë përcaktohen kriteret për mënyrën e vendosjes se pajisjeve në tregun publik dhe distancat që duhet të respektohen me qëllim ruajtjen e zonave lëvizëse të këmbësorëve dhe unifikimin e përdorimit të tyre. Bashkëlidhur harta treguese.



Neni 8 Pastrimi

1. Pastrimi i përgjithshëm i tregut apo i vendit ku është vendosur pajisja ambulante do të kryhet nga Bashkia Roskovec në përfundim të orarit të tregtimit, pas heqjes së pajisjeve dhe largimit të tregtarëve.
2. Njëkohësisht është e detyrueshme për çdo tregtar mbajtja pastër e vendit të tregtimit. Ata në asnjë rast nuk duhet të hedhin në tokë mbeturina apo mbetje të çfarëdo lloji, por duhet t'i grumbullojnë ato në vendet e caktuara për këtë qëllim.

Neni 9 Ndalimet


Ndalohet zënia e hapësirës publike në rastet kur :

1. pengon qarkullimin normal të këmbësorëve dhe automjeteve dhe cenon sigurinë publike, në buzë të trotuarit që korrespondon me vazhdimin e vijave të bardha për lëvizjen e këmbësorëve;
2. në ishujt e trafikut. Përjashtime bëjnë ato raste në të cilën kjo nuk përbën asnjë shqetësim për lëvizjen e këmbësorëve dhe atë të automjeteve;
3. në vendndalimet dhe vendqëndrimet e përcaktuara për mjetet e transportit;
4. në rastet kur bëhet pengesë për shikimin e sinjalistikës rrugore;
5. dëmton/cënon dekorin e qytetit;
6. nuk përmbush normat higjeno-sanitare;
7. bie në kundërshtim me interesat e komunitetit;
8. në vendet që ka monumente duhet lënë një hapësirë e nevojshme, e cila të mos e pengojë shikimin e monumentit;
9. Në kryqëzimet në të cilët nuk ka semaforë zënia e hapësirës publike mund të bëhet vetëm jashtë trekëndëshit të shikimit, pra të mos përbëjë asnjë vështirësi në shikim.

Neni 10 Mirëmbajtja dhe dëmtimet

Subjekti, i cili lejohej të ushtrojë aktivitet në tregun e ditës se diele duhet:

1. të garantojë një përdorim të sigurtë të hapësirës publike për kalimtarët, në përputhje me dekorin e qytetit dhe në gjendje perfekte higjeno-sanitare.
 2. të mirëmbajë pajisjet, të cilat duhet të jenë gjithnjë në rregull dhe të pastra dhe të mos të mbaj apo të vendos asnjë send tjetër, përveç asaj të miratuar në lejen për ushtrim aktiviteti (*kutia ambalazhi, etj*).
 3. të mbajë pajisjet në eficientë të plotë, në rast të kundërt ndaj tij do të merren masa deri në ndalimin e ushtrimit të aktivitetit në tregun publik .
 4. Çdo dëm që i shkaktohet hapësirës publike apo qytetarëve nga aktiviteti që zhvillohet, do t'i faturohet subjektit i cili është ushtron aktivitet në tregun publik .
- Dëmi ekonomik, si dëmtim në trotuar, pemë apo hapësirën e gjelbër, vlerësohet nga strukturat përkatëse të Bashkisë Roskovec në përputhje me aktet ligjore të miratuara për këtë qëllim.



Neni 11 Kthimi i hapësirës publike

1. Hapësira publike duhet të lihet e lirë nga çdo pajisje në rastet kur strukturat përkatëse të Bashkisë Roskovec duhet të kryejnë punime në interes të publikut, ose punime mirëmbajtje.
2. Kur hapësira publike duhet lënë e lirë në mënyrë urgjente, komunikimi nga ana e strukturave përkatëse mund të bëhet në mënyrë verbale duke konfirmuar në vijim e pa vonesë në formë të shkruar. Kur nuk është i mundur komunikimi verbal (*aktiviteti është mbyllur*), në këtë rast punonjësit e Policisë Bashkiake në bashkëpunim me strukturat përkatëse të Bashkisë Roskovec kryejnë lirimin e territorit dhe koston e punimeve ia faturojnë subjektit.
3. Nëse lirimi i saj nuk bëhet nga vetë subjekti, Policia Bashkiake në bashkëpunim me inspektorët e Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore marrin masa për lirimin e hapësirës publike dhe të gjitha shpenzimet për lirimin e saj i faturohen subjektit përgjegjës.

Neni 12 Masat ndëshkuese

1. Në të gjitha rastet kur organet inspektuese konstatojnë shkelje nga subjekti i interesuar të kushteve të përcaktuara në lejen për zënie e hapësirës publike, ndaj subjektit të interesuar do të merren masat ndëshkuese, si më poshtë:
 - a) Paralajmërim me shkrim/akt konstatimi;
 - b) Gjobë;
 - c) Pezullim;
 - d) Mos lejim i ushtrimit të aktivitetit në tregun publik.
2. Në kuptim të pikës 1 të këtij neni, konsiderohen shkelje:
 - b) Ushtrimi i aktivitetit në një hapësirë më të madhe se ajo e përcaktuar në lejen që i është dhënë;
 - c) Instalimi i pajisjeve për të cilat nuk ka marrë lejen përkatëse;
 - d) Kur mosmirëmbajtja e pajisjeve dëmton/cenon dekorin e qytetit ose përbën rrezik për jetën e qytetarëve;
 - e) Subjekti nuk mban pastër hapësirën e cila i është lënë në dispozicion;
 - f) Subjekti nuk paguan tarifën për zënie e hapësirës publike brenda afateve të përcaktuara në leje;
 - g) Subjekti prish qetësinë publike apo ka sjellje të padenjë;
 - h) Vazhdimi i aktivitetit edhe pas mbarimit të afatit të përcaktuar për zhvillimin e tregut
 - j) Në ato raste kur shkeljet mund të jenë të ndryshme dhe të sanksionuara në akte të tjera ligjore, nënligjore dhe rregullatore në fuqi.
3. Për çdo shkelje të konstatuar të lejes apo dëmtim i hapësirës publike do të merret masa e ndëshkimit me gjobë sipas akteve ligjore, nënligjore dhe akteve të miratuara për këtë qëllim nga Këshilli Bashkiak apo Kryetari Bashkisë.
4. Për secilën nga shkeljet e konstatuara masat ndëshkuese janë të integruara/kumulative, sipas natyrës dhe rëndësisë së shkeljes. Masat për çdo shkelje do merren sipas procedurave të ndjekura nga organet inspektuese konform kësaj rregullore dhe ligjeve në fuqi.
5. Organi inspektues në rastet kur ka zënie abuzive urdhëron që subjekti të marrë masat për të lënë të lirë hapësirën publike brenda një afati 5 ditor. Nëse subjekti nuk respekton afatin, atëherë



inspektorët e terrenit të Policisë Bashkiake në bashkëpunim me inspektorët e Drejtorine e te ardhurave vendore do të lirojnë hapësirën e zënë dhe shpenzimet për këtë i faturohen subjektit.

6. Aktet e kontrollit, të mbajtura gjatë inspektimit, ankimohen nga subjekti i interesuar në përputhje me Ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” të cilat më pas i dërgohen për vlerësim Kryetarit të Bashkisë.

KREU II DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 13 Strukturat zbatuese

Strukturat e ngarkuara për zbatimin e kësaj rregullore në lidhje me lejet për shfrytëzimin e hapësirës publike, si dhe mbrojtjen dhe garantimin e përdorimit të hapësirës publike janë:

1. Drejtoria e te ardhurave vendore organ inspektues në lidhje me shlyerjen e detyrimeve për pagesën e tarifës për zënie e hapësirës publike.
2. Policia Bashkiake – organ inspektues për respektimin e kushteve të përgjithshme të kësaj rregulloreje. Vendos e zbaton sanksionet në bazë të kësaj rregulloreje, dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Policia Bashkiake mbështet gjithashtu inspektorët e Drejtorisë së te ardhurave Vendore në bazë të nenit 4, pika 3 të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar), nëse do të jetë e nevojshme.

Neni 14 Hyrja në fuqi

- Kjo rregullore hyn në fuqi në bazë të ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 55 pika 6.

KRYETAR

Kadri Hyska

